



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Fakulteti Ekonomik

DEKANI

Nr. 391 Prot

Shkodër, më 27.03.2025

URDHËR


Nr. 2, Datë 27.03.2025

**"MBI RREGJISTRIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË PROGRAMIN DOKTORATË
NË EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM"**

Në mbështetje të Ligjit me Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" nenet 3,23,25,77,78,79,124; Ligjit me Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë" nenet 16,21,22,24,25,27,28/3,46 të tij. Ligji Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, "Për kodin e cilësisë së arsimit të lartë", Shtojca nr. 6 "Standartet e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të tretë Doktoratë"; VKM nr. 112, datë 23.02.2018 (i ndryshuar) "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore Doktor dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademik Profesor i asociuar dhe Profesor" Kreu i parë; vendimit nr. 5, datë 25.03.2025, me subjekt "Mbi miratimin përfundimtar të listës së aplikantëve fitues në programin e studimit doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" dhe në nent nr 3.13;3.14;3.16;3.16 të Rregullores "Për organizimin e programit të studimit të doktoraturës në Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm,

Urdhëroj:

1. Kandidatët fitues të rregjistrohen brenda periudhës dy javore (27.03.2025 – 09.04.2025), nga data e shpalljes 27.03.2025 të listës së kandidatëve fitues në sekretarinë e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Shkodrës që ofron programin e doktoratës "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm".
2. Në se një kandidat tërhiqet ose nuk rregjistrohet brenda afatit të përcaktuar, atëherë ai e humbet të drejtën e vazhdimit të studimeve të doktoratës dhe në vend të tij, rregjistrohet kandidati vijues në listën përfundimtare brenda një afati 5 ditë pune.
3. Dokumentacioni i aplikimit të kandidatëve fitues, depozitohet në njësinë përgjegjëse dhe pasurohet gradualisht me të gjithë dokumentacionin që provon ecurinë e doktorantit.



Kandidatët fitues të paguajnë tarifën e regjistrimit (3,000 ALL) për programin e studimit të doktoratës ku janë shpallur fitues dhe të paraqesin mandatin e pagesës bë momentin e regjistrimit. Kandidatët jo fitues ju kthehet dosja individuale me dokumentet e aplikimit, sipas kërkesës së tyre.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



Dekani
Prof As Dr. Elidiana Bashi